VENDIM
Nr. 58, datë 27.1.2016

PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA GRAMSH, TË PRONËS NR. 334, ME EMËRTIM "ISH-REPARTI USHTARAK NR. 9920, GRUP DEPO", ME VENDNDODHJE "PËRROI I ÇEKREZIT", GRAMSH, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR

(Ndryshuar me VKM nr. 265, datë 12.5.2021)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Gramsh, të pronës nr. 334, me emërtim "Ish-reparti ushtarak nr. 9920, Grup Depo", me vendndodhje "Përroi i Çekrezit", Gramsh, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, *për ta përdorur në fushën e shërbimit funeral.*

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të hiqet prona nr. 334, me emërtim "Ish-reparti ushtarak nr. 9920, Grup Depo", me vendndodhje "Përroi i Çekrezit", Gramsh, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i janë transferuar në pronësi ose në përdorim Bashkisë Gramsh.

3. Bashkisë Gramsh i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryetari i Bashkisë Gramsh, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLAN VENDOSJA E ISH REP. USHT. NR.9920 PRONA NR.334
GRUP DEPO PËRROI I CEKREZIT, GRAMSH.

Sistemi i koordinatave shteterore